

VENDIM
Nr.39, datë 3.2.2000

PËR PROKURIMIN E DREJTPËRDREJTË PËR PRODHIMIN DHE KONFEKSIONIMIN E VESHJEVE, TË ARTIKUJVE PËR FJETJE, SARACERIE, DHE TË KEPUCËVE GJYSMA, PËR NEVOJAT E USHTRISË ME NDËRMARRJEN E PRODHIMIT TË VESHJEVE TË USHTRISË.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, pika 3, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, "Për Prokurimin Publik", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1. Ministria e Mbrojtjes, për garantimin e cilësisë, të dizenjove, standardeve të paraqitjes estetike, të furnizimit ritmik të ushtrisë dhe për përballimin e urgjencave për veshje, saraceri, këpucë gjysma, te prokurojë, per vitin 2000, drejtpërdrejtë me ndërmarrjen e prodhimit të veshjeve të ushtrisë, ne Tiranë për artikujt e mëposhtëm :

a) Për prodhimin dhe konfeksionimin e veshjeve: kostume teritali, ushtarake e civile, kostume kamuflazhi, për kuadro dhe ushtarë, xhupa, veshje te brendshme, verore e dimërore, për ushtarë, çarçafë, dyshekë.

b) Për prodhime saraci: mbulesa për sistemet e artilerisë, te aviacionit, tankeve, automjeteve, për ndërlidhjen, për kiminë, për armatimin e lehtë, municionet, jelekë për mbajtjen e pajimeve të ndryshme për ushtarët, pajime për kafshët, çadra për fushimin e ushtrisë.

c) Për prodhim këpucësh: vetëm për këpucë gjysma për kuadrot.

Specifikimi me i hollësishëm i konfeksionimeve, që do të realizohen me prokurim të drejtpërdrejtë, jepet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Çmimet e prodhimit dhe të konfeksionimit për çdo artikull të hartohen nga ndërmarrja e prodhimit të veshjeve të ushtrisë, me analiza analitike të kostos, kurse negociimi dhe miratimi i tyre të bëhet nga Ministria e Mbrojtjes.

3. Enti prokurues, i autorizuar nga Ministria e Mbrojtjes, me miratimin e çmimeve, të lidhë kontratë me ndërmarrjen e prodhimit të veshjeve të ushtrisë, ku të shënohen të gjitha specifikimet e nevojshme teknike të prodhimit të dorëzimit të mallit. Në kontratë, për rastet e konfeksionimit, të specifikohet edhe ritmika e furnizimit me lëndë të para nga enti prokurues.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

Nr.	Emërtimi i artikullit	Çmimi	Karakteristikat Teknike	Lloji i prodhimit
1.	2.	3.	4.	5.
A.	PRODHIME SARACERIE			
1.	Mbulese komplet mitrolozi 14.5mm 4-grykësh	9099	Suprime teknike Kunder depertimit ujit e veprimeve te agjenteve atmosferike	Me Material Porositesi
2.	Mbulese komplet topi 37mm KA një-grykësh	9642	„ „	„ „
3.	Mbulese komplet topi 37mm KA dy-grykesh	11376	„ „	„ „
4.	Mbulese komplet topi 57mm KA	20592	„ „	„ „

5.	Mbulese komplet topi 85mm fushor	16505	„ „	„ „
6.	Mbulese komplet topi 100mm KA	16159	„ „	„ „
7.	Mbulese komplet topi 122mm,fush	13324	„ „	„ „
8.	Mbulese komplet topi obus 122mm	16943	„ „	„ „
9	Mbulese komplet topi obus 152mm Fushor.	16576	„ „	„ „
10.	Mbulese komplet per avion	16350	„ „	„ „
11.	Mbulese komplet per helikopter	13750	„ „	„ „
12.	Çadra te medha ushtari	30880	„ „	„ „
13.	Çadra te mesme ushtari	18000	„ „	„ „
14.	Çadra te vogla shtabi	14000	„ „	„ „
15.	Çadra kuzhine	30000	„ „	„ „
16.	Çadra spitali	30000	„ „	„ „
17.	Flete çadre	12000	„ „	„ „
18.	Çanta shpine	10400	„ „	„ „
B.	VESHJE KUADRI (oficer-n/oficer)			
1.	Pardesy	3198	Stof terital	„ „
2.	Xhup kamuflazhi	4000	Kamuflazh	„ „
3.	Kostum ceremonial kuadri	5283	Stof terital	„ „
a.	Xhaketë	3241	„ „	„ „
b.	Pantallona	804	„ „	„ „
c.	Kapele	455	„ „	„ „
4.	Kostum pune kuadri	1666	„ „	„ „
a.	Xhaketë	892	„ „	„ „
b.	Pantallona	562	„ „	„ „
c.	Kapele	212	„ „	„ „
5.	Këmishë kuadri me mëngë të shkurtra	301	„ „	„ „

1.	2	3	4	5
6.	Këmishe kuadri me mëngë të gjata	365	„ „	„ „
7.	Kravate	73	„ „	„ „
8.	Pantallona vere kuadri	562	„ „	„ „
9.	Kapele vere kuadri	892	„ „	„ „
10.	Kostum stërvitje dimërore Kamuflazhi (kuadri)	1666	Kamuflazhi	„ „
a.	Xhakete	892	„ „	„ „
b.	Pantallona	562	„ „	„ „
c.	Kapele	212	„ „	„ „
11.	Kostum stërvitje verore kamuflazhi (verore)	1666	„ „	„ „
a.	Xhakete	892	„ „	„ „
b.	Pantallona	562	„ „	„ „
c.	Kapele	212	„ „	„ „
12.	Kepuce ½ kuadri	2500	Lekure poliureta	„ „
C.	VESHJE USHTARI			
1.	Xhupa kamuflazhi	40000	Kamuflazh	„ „
2.	Kostum dimeror kamuflazhi ushtari	1400	„ „	„ „
a.	Xhaketë	800	„ „	„ „
b.	Pantallona	420	„ „	„ „
c.	Kapele	200	„ „	„ „
3.	Kostum veror kamuflazhi ushtari	1400	„ „	„ „
a.	Xhakete	800	„ „	„ „

b.	Pantallona	420	„ „	„ „
c.	Kapele	200	„ „	„ „
4.	Të brendshme dimri	930	Fanellate	„ „
a.	Këmisha	630	„ „	„ „
b.	Benevreke	300	„ „	„ „
5.	Te brendshme vere	460	Pelhure	„ „
a.	Këmisha	320		„ „
b.	Mbathje	140		„ „
6.	Pece kembesh dimri	150	Fanellate	„ „
7.	Pece kembesh vere	120	Pelhure	„ „
8.	Shami dore	100	Kambrik	„ „
9.	Kostum stervitje per floten	1666	Dok	„ „
a.	Xhakete doku per floten	892	Dok	„ „
b.	Pantallon doku per floten	562	Dok	„ „
c.	Kapele doku per floten	212	Dok	„ „
D.	MATERIALE PER FJETJE			
1.	Çarçafe	498	Kambrik	„ „
2.	Kellef dysheku	800	Dok	„ „
3.	Dyshek te mbushur	2323	Dok+pamb(lesh)	„ „
4.	Kellef jasteku	180	Kambrik	„ „